

**V E N D I M**

**Nr. 4 datë 02.04.2021**

**“PËR**

**MIRATIMIN E NUMRIT TË ANËTARËVE TË REDAKSISË SË BOTIMEVE TË KOLANËS (6 në total, me pjesëmarrje të një përfaqësuesi të QSPA-së, dy përfaqësuesve të ASHSH-së, dy përfaqësuesve të ASA-s dhe një studiuesi arbëresh)”**

Bazuar në Ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 për *“Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”*, Vendimin nr.601, datë 04.09.2019, *“Për krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët”*, si dhe aktet nënligjore në fuqi, me propozimin e drejtorit të QSPA-së,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e numrit të anëtarëve të Redaksisë së Botimeve të Kolanës (6 në total, me pjesëmarrje të një përfaqësuesi të QSPA-së, dy përfaqësuesve të ASHSH-së, dy përfaqësuesve të ASA-s dhe një studiuesi arbëresh).
2. Ngarkohet Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar i Këshillit Koordinues të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët**

**Prof. Merita Bruçi**